



Asociacioni i Komunave të Kosovës

RAPORT

nga

Takimi i Kolegjiumit për Ekonomi dhe Zhvillim

Gjakovë, 06 qershor 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjiumit për Ekonomi dhe Zhvillim



HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë për Ekonomi dhe Zhvillim organizoi takimin e parë të Kolegjiut për këtë vit në restorantin „Çarshia e Jupave“ në Gjakovë me datën 06 qershor 2011 (e hënë) me fillim nga ora 11:00.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

1. Themelimi i one-stop shopeve në të gjitha komunat (eliminimi i pengesave për bizneset)
2. Përshpejtimi i bartjes së kompetencave për regjistrimin e bizneseve në të gjitha komunat
3. Identifikimi i pjesëmarrësve në grupet punuese në procesin legjislativ

Në këtë takim morën pjesë Drejtorë të Drejtorive për Ekonomi dhe Zhvillim të Komunave të Kosovës, si dhe përfaqësues nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Takimi u kryesua nga Kryesuesi i Kolegjiut për Ekonomi dhe Zhvillim z. Shpëtim Reznici.

PËRMBLEDHJE

z. Shpëtim Reznici, Kryesues i Kolegjiut: falënderoj AKK-në për organizimin e këtij takimi të parë dhe po ashtu falënderoj të gjithë për pjesëmarrje, mirëpo shprehi keqardhje pse përfaqësuesit e MTI-së nuk iu janë përgjigjur ftesës për këtë takim. Kryesuesi prezantoi rendin e ditës, dhe pas miratimit në mënyrë unanime vazhdoi me pikën e parë.

- Themelimi i one-stop shopeve në të gjitha komunat (eliminimi i pengesave për bizneset)

z. Reznici: sqaroi se themelimi i këtyre qendrave ka për qëllim kryesor mbështetje të një mjedisi më miqësorë dhe shërbime këshilluese për biznese nëpërmes qendrës “One Stop Shop” ku bizneset do mund t’i përfundojnë të gjitha shërbimet në lidhje me institucionet publike.

Nëpër disa komuna të Kosovës janë dukur hapur “One stop-shop-et”, të cilat shërbejnë për aplikim në regjistrimin e bizneseve, të cilat do të sjellin lehtësira në bërjen e biznesit në Kosovë.

z. Ertan Munoglu, Menaxher Programi në AKK: informoj të pranishmit për konferencën e zhvillimit ekonomik të organizuar nga Qeveria një javë më parë ki u diskutua për zhvillim ekonomik më të qëndrueshëm, ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për lehtësira në fushën e biznesit si: regjistrimi i biznesit, zonat ekonomike, one stop shop, investime të jashtme, si dhe mënyrat e ngritjes së bashkëpunimit mes nivelit qendror dhe lokal i cili do të ndihmojë këto procese drejt një zhvillimi ekonomik të komunave.

z. Xhevdet Shkreta, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik - Hani i Elezit: argumentoj rëndësinë e madhe në hapjen e këtyre qendrave të tilla ku të gjitha informacionet do të sigurohen në një vend dhe nuk do të ketë humbje kohe dhe energjie. Mirëpo duhet të kemi të qartë bazën juridike të këtyre qendrave, dhe palëve duhet shpjeguar rëndësinë e këtyre qendrave.

z. Qazim Loxha, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik - Istog : sugjeroj të ndryshohet emri nga one stop shop në qendër për regjistrimin e biznesit - kjo le të jetë një kërkesë po ashtu drejtuar AKK-së sepse është e nevojshme të përdoren terma më të thjeshtë dhe adekuat në gjuhën shqipe. Këto qendra do të krijojnë një klimë të nevojshme për zhvillimin e bizneseve në komuna dhe një bashkëpunim më të fortë mes nivelit qendror dhe lokal.

z. Yahya Mazrek, Drejtor i Financave dhe Zhvillimit Ekonomik – Mamushë: bëri me dije se Komuna nuk ka asnjë informatë për hapjen e këtyre qendrave, trajnimit të stafit si dhe ambientin se ku do të hapen këto qendra. Andaj do duhej të kishte një sqarim për këto procese.

z. Reznici: siguroj se do të ngritin këtë çështje edhe tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ku do u dërgohet një shkresë për informim përmes AKK-së, dhe të diskutohet kjo çështje bashkërisht.

z. Halil Tolaj, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik – Deçan: ne diskutimin e tij përmendi se këto kompetenca kanë qenë më herët në komuna në vitin 2001 dhe pastaj janë marrë. Tani është me rëndësi të ketë një sqarim se a do të jenë këto kompetenca komunale, dhe a janë bartur edhe fondet e nevojshme për hapjen e këtyre qendrave? Duhet të njoftohemi gjithashtu edhe për procedurat e nevojshme në punë sepse duhet një staf i ri në zyrë.

z. Isak Mehmeti, shef për ekonomi - Prishtinë: duke u ndërlidhur me diskutimin sqaroi se one stop shop (OSSH) dhe regjistrimi i bizneseve janë gjëra të ndryshme, sepse OSSH-të i përkasin një segmenti më të gjerë. Kemi filluar me këto qendra si një vend ku komuniteti i biznesit të jetë në hap përpara sa i përket informimit, orientimit të interesave të biznesit, investimeve të jashtme, pra një informim i përgjithshëm në të gjitha sferat. Komunitat duhet patjetër të sigurojnë hapësirat e nevojshme, ngritjen e kapaciteteve për këto qendra, të cilat do të jenë në bashkëpunim me donatorët e jashtëm siç është Komisioni Evropian. Sa i përket kompetencave ato duhet të barten në komuna deri në fund të vitit - kjo çështje është ngritur edhe nga AKK-ja - sepse është e nevojshme lehtësimi i procedurave për biznesin sa i përket informacionit, taksave, lehtësirave ekonomike, si dhe zonat e lira ekonomike.

➤ Përshpejtimi i bartjes së kompetencave për regjistrimin e bizneseve në të gjitha komunat

z. Munoglu: kemi rekomandime nga MTI-ja se si masë për lehtësimin e biznesit do të heq lejet e punës. Edhe pse kemi shprehur brengën tonë se kjo do të shkurtojë të ardhurat e komunës, nga ministria kanë konsideruar se kjo do të jetë vetëm në një periudhë afatshkurtër kurse në periudha afatgjata ato do të gjenerojnë të ardhura prej bizneseve të cilat do të operojnë në komuna.

z. Qazim Loxha, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik - Istog: shtoj se mbledhja e kaluar mes AKK-së dhe ministres së MTI-së ka qenë shumë e rëndësishme dhe është mirë që edhe në këto takime të Kolegjiumit të ketë përfaqësues të MTI-së të japin sqarimet e duhura rreth procedurave të nevojshme. Të sqarojmë se nuk ka asnjë pengesë nga komunat për bizneset, por pengesat vijnë nga ministria e cila ndërmerr të gjitha veprimet rreth akteve normative në fushën e biznesit.

z. Agim Salihu, shef i zyrës ligjore – Prishtinë: është me rëndësi të sqarohet se a do të jete kjo kompetencë e përhershme në komuna dhe a do të jetë kjo në kuadër të zyrës pritëse? Për më tepër nuk

duket se është bërë vlerësimi rreth kostos së themelimit të këtyre qendrave janë pasojave në organogramet/përshkrimin e vendeve të punës të stafit komunal. Komunitat kanë përgatitur rregulloret e brendshme për taksat, tarifat dhe gjobat si dhe për investime të jashtme. Ekzistojnë rreth 8,000 objekte pa leje në Prishtinë dhe kjo vështirëson regjistrimin dhe funksionimin e bizneseve. Të njëjtat probleme po shkaktojnë edhe ushtrimi i veprimtarisë në objektet pa leje, p.sh. regjistrimi i biznesit në një ndërtesë prej 8 kateve ndërsa adresa është në katin e 12-të.

z. Ahmet Bahtijari, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik -Dragash: MTI ka kontroll të plotë në regjistrim të biznesit sepse ne ende nuk dimë për numrin e bizneseve të regjistruara në Komunë - edhe pse thuhet se kjo kompetencë është deleguar MTI ende mban përgjegjësi të madhe. Nuk kemi një shifër të saktë se cilat janë ato biznese të regjistruara apo çregjistruara, me leja apo pa leje, cilat operojnë e cilat nuk operojnë në Komunë. Edhe të hyrat nga mjetet e regjistrimit kalojnë në MTI, ndërsa puna e mbikëqyrjes nga ana e inspektorëve ka dështuar në vënien e rregullit të përgjithshëm. Me këtë rast patjetër duhet të ketë një koordinim më të mirë të punëve në mes niveleve të ndryshme. Pengesat për biznese vijnë nga niveli qendror, e jo nga komunitat; p.sh. certifikata për çregjistrim të bizneseve lëshohet nga M e Financave pas 6 muajve për arsye se duhet pritur auditivin e brendshëm, shpalljen publike për mbyllje të biznesit, etj.

Krijimi i OSSH nuk është në interes të komunave të vogla sepse kjo shkakton pasojë në buxhet dhe staf, mirëpo regjistrimi i bizneseve duhet kaluar në komuna.

- Identifikimi i pjesëmarrësve në grupet punuese në procesin legjislativ

z. Rezniqi: Si përfundim u la që edhe njëherë gjatë konsultimeve me Drejtorë të Kolegjiumit të vendoset në përcaktimin e personave të përshtatshëm të cilët do të përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e Komunave në grupet punuese për projektligjet në fjalë.

REKOMANDIMET:

- Të përshpejtohet delegimi i kompetencave në Komuna për regjistrimin e bizneseve
- Përfaqësuesit e Kolegjiumit në grupet punuese legjislative të përcaktohen në takimin e radhës